



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:031894

Datë: 25.07.2023

Numri i dokumentit: 04519981

C.nr.408/2023

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil, gjyqtarja Njomëza Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. në çështjen juridiko-kontestimore të paditësve E.Sh., S.G., E.D., L.D. dhe E.Xh.S. të gjithë mësimdhënës pranë Gjinnazit “Remzi Ademaj” në Prizren, të ciliët i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, rr. “.....” kundër të paditurës Komuna e Prizrenit Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren DKA, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, jashtë seancës gjyqësore, me datë 25.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Pa shqyrtim kryesor të çështjes-

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve E.Sh., S.G., E.D., L.D. dhe E.Xh.S. nga Prizreni.
- II. DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që paditësve në emër të shujtave ditore për ditë të pranisë në punë prej datës 01.01.2022 deri më 21.11.2022 t’ia pauajë si në vijim:
- Paditëses E.Sh. për 58 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro, shumën prej 116.00 euro,
 - Paditëses S.G. për 59 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro, shumën prej 118.00 euro,
 - Paditëses E.D. për 179 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro, shumën prej 358.00 euro,
 - Paditësit L.D. për 189 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro, shumën prej 378.00 euro
 - Paditëses E.Xh.S. për 189 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) euro, shumën prej 378.00 euro.

E në shumën e përgjithshme prej **1,348.00 euro** dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (03.02.2023) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 342.00 € (njëqind e njëzet e katër) euro në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit E.Sh., S.G., E.D., L.D. dhe E.Xh.S. nga Prizreni, të cilën me autorizim i të ciliët i përfaqëson av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 03.02.2023, me kërkesë për kompensimin e shujtave ditore për ushqim në punë për periudhën 10.01.2022 – 21.11.2022 kundër të paditurës Komuna e Prizrenit. Në padi, ka theksuar se paditësve – mësimdhënësve i takon kompensimi për shujtat ditore me nga 2 (dy) euro në ditë për çdo ditë pune. Siç parashihet me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë edhe pse kemi bërë kërkesa të vazhdueshme për pagesën e shujtave pranë DKA-së nuk është marrë asnjë përgjigje. E meqenëse komuna nuk e ka përbushur vullnetarisht këtë detyrim ka kërkuar nga Gjykata që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë dhe të obligohet e paditura që paditësve si mësimdhënës pranë Gjimnazit “Remzi Ademaj” në Prizren, në emër të shujtave ditore për periudhën 10.01.2022 deri 21.11.2022 për ditët e pranisë në punë si në dispozitivin II të këtij aktgjykimi t'ia paguajë shumat që i takojnë. Po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale për Arsim, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që Gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi i shujtave është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 i Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtarë e kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar Gjykatës në kundërshtim me nenin 124 paragrafin 6.1 të Ligjit për Procedurën Administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përbushjen e detyrimit, e paditura thirret në atë se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e paditësve, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit E.Sh., S.G., E.D., L.D. dhe E.Xh.S. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë Gjimnazin “Remzi Ademaj”, në Prizren.

Gjykata, përmes vërtetimit 41/2023 të datës 16.01.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësja E.Sh. në periudhën 26.06.2022 deri me 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 58 ditë pune, përmes vërtetimit 43/2023 të datës 16.01.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësja S.G. në periudhën 26.06.2022 deri me 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 59 ditë pune, përmes vërtetimit 46/2023 të datës 13.01.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësja E.D. në periudhën 10.12.2021 deri me 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 179 ditë pune, përmes vërtetimit 52/2023 të datës 13.01.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësi L.D. në periudhën 10.01.2022 deri me 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 189 ditë pune dhe përmes vërtetimit 56/2023 të datës 13.01.2023 të lëshuar nga e paditura vërtetoi se paditësja E.S. në periudhën 10.01.2022 deri me 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 189 ditë pune.

Vërtetimet në fjalë, Gjykata e pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj, meqë ky dokument është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tilla është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimi i lëshuar nga Drejtori i Shkollës së Gjimnazit “Remzi Ademaj”, në Prizren, si provë me të cilën vërtetohen fakti lidhur me ditët e prezencës gjykata ia fali besimin e plotë, e nga i cilat vërtetoi faktin se paditësit kanë prezantuar në punë siç është cekur në dispozitivin II të këtij aktgjykimi.

Me nenin neni 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, parashihet se “*Të punësuarve u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kane marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore*”.

Nga provat e cekura si më lartë dhe dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë çështjen e shpenzimeve të ushqimit gjatë punës, gjykata erdhi në përfundim se paditësit e kanë të drejtën që të kërkojë nga e paditura kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, respektivisht shujtave ditore.

Gjykata nga provat bashkangjitura padisë gjeti se paditësit janë në marrëdhënie pune pranë Gjimnazit “Remzi Ademaj” në Prizren, si mësimdhënës. Paditësit për periudhën kohore gjatë vitit 2022 ka qenë i pranishëm, fakt ky i vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga institucioni, ku paditësit punonjnë. Duke u nisur nga fakti se e paditura paditësve nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të paraparë me dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit e detyroi të paditurën si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i paditura me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 189 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigje të padisë, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në pikën II të dispozitivit, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (03.02.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore shumën prej 30.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 342.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:031894, 25.07.2023

B. profesional
Delvina Ajazaj

Gjyqtarja
Njomëza Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.